



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.277, datë 25.05.2023

“PËR

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
VITI KALENDARIK 2022, PËR GJYQTARIN {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Yllka Rupa, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2022,

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

1.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20, datë 18.01.2023 ka hapur 10 (dhjetë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 10 (dhjetë) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile. Po kështu, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 ka hapur 4 (katër) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile.

1.2 Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet e mësipërme, Këshilli pasi ka verifikuar përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, në pikën e parë të tij, ka vendosur miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023. Sipas këtij vendimi, vetëm për katër gjyqtarë konkretisht për gjyqtarët Artan Jahollari, Gentian Marku, Nertila Kape dhe {...}, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e

vlerësimit që përfshin vitin e fundit kalendarik, përkatësisht vitin 2022, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional.

1.3 Pas marrjes së këtij vendimi, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), nenit 25 të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me vendimin nr. 144, datë 28.3.2023, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarët znj. Nertila Kape, z. Artan Jahollari, z. Gentian Marku dhe z. {...}.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

.... Për gjyqtarin {...} – relatore znj. Yllka Rupa – nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.”.

1.4 Pas marrjes së këtij vendimi, ka vijuar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit, duke u kryer veprimet si më poshtë:

Më datë 28.3.2023, bazuar në nenin 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, i është njoftuar gjyqtarit vendimi për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar dhe emrat e vlerësuesve, nëpërmjet postës elektronike. Ndërkohë që procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar nuk ka përfunduar, Këshilli me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023, pas shqyrtimit të kërkesës së kandidatit për tërheqjen nga kandidimi për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, ka vendosur përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin {...}.

1.5 Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele për shkak të tërheqjes së kandidatit, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2022 nuk mund të vazhdojë, pasi kjo procedurë vlerësimi, ka filluar për shkak të kandidimit për të gjyqtarit për lëvizje paralele.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

2.1 Neni 97 i Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: *“1.Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur....”*.

2.2 Neni 25 i ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, parashikon se: *“....3. Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre”*.

2.3 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me rregullat e posaçme për vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare, në nenin 22, parashikohet se: *“1.Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarit. 2. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përshpejtuar me kërkesë, me afate të përgjysmuara nga ato të parashikuara në nenin 18 të këtij vendimi”*.

2.4 Neni 97 pika 3 i Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikon : *”Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.”*.

2.5 Ndërkohë në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se : *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”*.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

3.1 Procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar etik dhe profesional të gjyqtarit {...} ka filluar me vendimin nr. 144, datë 28.03.2023, pas marrjes së vendimit nr. 77, datë 13.02.2023, për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023.

3.2 Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit, Këshilli me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023, pas shqyrtimit të kërkesës së kandidatit për tërheqjen nga kandidimi për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, datë 18.01.2023, ka vendosur përfundimin e procedurës.

3.3 Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele për shkak të tërheqjes së kandidatit, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2022 nuk mund të vazhdojë për shkak se kjo procedurë vlerësimi, e filluar në rastin konkret për shkak të kandidatit për lëvizje paralele, zhvillohet bazuar në nenin 97 të Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se gjyqtari vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve.

3.4 Në vendimin e KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nenin 22 të tij, janë përcaktuar rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare¹. Këto rregulla parashikojnë detyrimin e Këshillit që, në çdo rast të aplikimit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele, të bëjë vlerësim të përshpejtuar, pa kërkesë të gjyqtarit, duke respektuar rregullat e vlerësimit të përshpejtuar me afate të përgjysmuara.

3.5 Zhvillimi i kësaj procedure, e cila iniciohet pas kërkesës së gjyqtarit për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë dhe kualifikimit të tij për plotësim të kriterëve ligjore, synon të garantojë zhvillimin e një procesi të shpejtë, efektiv dhe të njëjtë vlerësimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, për të siguruar të paktën 1 vlerësim profesional në kohë, të njëjtë dhe real me atë të kërkesës së gjyqtarit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele.

3.6 Në kushtet kur procedura e lëvizjes paralele, për shkak të së cilës ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2022 për gjyqtarin {...} nuk ekziston, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar.

¹ “1. Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarit. 2. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përshpejtuar me kërkesë, me afate të përgjysmuara nga ato të parashikuara në nenin 18 të këtij vendimi”.

3.7 Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohen rastet se kur organi publik deklaron të përfunduar një procedurë administrative të filluar pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen.

3.8 Në rastin konkret, me deklarinimin e përfundimit të procedurës për lëvizje paralele, shkak për të cilin ka filluar me prioritet procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, ka rënë shkak për të cilin kjo e fundit ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston më. Për pasojë vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar nuk mund të vazhdojë. Ndërkohë viti kalendarik 2022 për të cilin kishte filluar kjo procedurë vlerësimi për gjyqtarin z. {...}, do të përfshihet në periudhën 5 vjeçare të vlerësimit në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të Ligjit për Statusin.

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për gjyqtarin {...}, e filluar me vendimin nr. 144, datë 28.03.2023, duhet të përfundojë pa vendim përfundimtar, për shkak të rënies së shkakut të fillimit të saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr.77, datë 13.02.2023 “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”, dhe atë nr. 144, datë 28.3.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Viti kalendarik 2022 do të përfshihet në periudhën 5/vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.
3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR